



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE SHKALLA E PARË

V L O R Ë

Nr.613 Akti
Datë 18.02.2016

Nr.580 Vendimi
Datë 19.04.2016

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Administrative Shkalla e Pare Vlorë, e përbërë nga:

GJYQTARE: Gentiana XHELILI

asistuar prej sekretares gjyqësore Edlira Shehu, sot më datë 19.04.2016 mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore publike, çështjen administrative me nr.613 Akti, që u përket palëve:

PADITËS: Denion Çelaj, Person Fizik, Fier, me nr-L43413401P NUIS, adresa lagja "15 Tetori" rruga Jakov Milaj, Fier, (në mungesë).

I PADITUR: 1-Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, përfaqësuar në gjykim me autorizimin me nr.4617/2 prot datë 07.03.2016 nga Ervisa Shabani.
2-Drejtoria e Apelit Tatimor Tiranë,(në mungesë).

Me pjesëmarrjen e Avokaturës së Shtetit Zyra Vendore Vlorë, (në mungesë).

OBJEKTI: 1-Kundershtimin e akti administrative "Njoftim Vlerësimi per Detyrimet Tatimore", nr.21514 prot datë 11.11.2015 "gjobe", per punemarres te padeklaruar ne shumen 50'000 leke.

2-Kundershtimin e "Vendimit te Ankimit" Nr.40779/1 prot. Datë 26.01.2016.

3-Konstatimi absolutisht i pavlefshem i "akteve admnistrative", 1- "Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore", nr.21514 prot datë 11.11.2015 "gjobe", per punemarres te padeklaruar ne Shumen 50.000 leke, 2- Vendimi per Ankimin Nr.40779 prot datë 28.01.2016, si Akte Administrative te nxjerra ne kundershkrim flagrant me ligjin.

BAZA LIGJORE: Neni 31, 32/a, 154 e vijues te K.Pr.Civile, Neni 11, 17/a,b, 35 te ligjit 49/2012 "Per organizimin e funksionimin e gjykatave amnisitrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative". Nenet 106,108 & 109 te ligjit 9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Udhezimi i Ministrit te Financave Nr.24 datë 02.09.2008.

Gjykata, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, pasi administroi provat

shkresore, pala e paditur person fizik Denion Çelaj nuk u dëgjua në konkluzione përfundimtare pasi ishte në mungesë dhe nuk ka depozituar pranë sekretarisë gjyqësore të kësaj gjykate konkluzione përfundimtare me shkrim, pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Fier me anë të përfaqësueses së saj ka kërkuar nga gjykata rrëzimin e kërkesë padisë, pala e paditur Drejtoria Apelit Tatimor Tiranë nuk u dëgjua dhe nuk ka paraqitur prapësime apo konkluzione përfundimtare me shkrim pranë sekretarisë gjyqësore të kësaj gjykate, pasi ka vijuar gjykimi në mungesë të saj me gjithë njoftimin e rregullt që ka pasur për procesin gjyqësor, pala pjesëmarrëse në gjykim Avokatura e Shtetit Zyra Vendore Vlorë nuk u dëgjua dhe nuk ka paraqitur prapësime apo konkluzione përfundimtare me shkrim pranë sekretarisë gjyqësore të kësaj gjykate, pasi ka vijuar gjykimi në mungesë të saj me gjithë njoftimin e rregullt që ka pasur për procesin gjyqësor dhe si shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Se paditësi person fizik Denion Çelaj i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë me kërkesë padinë me objektin e mësipërm.

Përpara shqyrtimit të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë në prova të kërkesëpadisë, gjykata konstatoi se në bazë të neneve 7,10,11 të ligjit me nr.49/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", çështja objekt gjykimi hyn në juridiksionin gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore dhe tokësore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

Në bazë të nenit 12 të ligjit me nr.49/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", gjykimi u zhvillua me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar.

Gjykata kryesisht bazuar në nenin 125 dhe 193 të K.Pr.Civile ka vendosur të thërrase përfaqësuesen e interesave të shtetit Avokatura e Shtetit Zyra Vendore Vlore.

Rrethanat e faktit:

Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi se pala paditëse person fizik Denion Çelaj është i pajisur me nr-L43413401P NUIS, me adrese lagja "15 Tetori", rruga "Jakov Mile", Fier, i cili me ushtron aktivitetin e tij "tregtim me pakice e frutave dhe perimeve".

Rezulton se në datë 15.09.2015 pranë subjektit person fizik Denion Çelaj është ushtruar kontroll nga Inspektoret e Drejtorise Rajonale Tatimore Fier dhe ku në përfundim është akt konstatimi me nr.0529788 serial datë 15.09.2015, nepermjet se cilit është konstatuar se në punë është gjetur shtetësja Trendelina Çela, e cila nuk figuron e siguruar në skemen e sigurimeve në listepagesen e muajit Shtator 2015.

Në vijim nga ana e Inspektoret e Drejtorise Rajonale Tatimore Fier është mbajtur procesverbali i gjobes me nr.0179057 serie datë 15.09.2015 ku rezulton se pranë subjekti fizik Denion Çelaj gjatë kontrollit është gjetur Trendelina Çela e cila nuk është e regjistruar në skemen e sigurimeve në listepagesen e muajit Shtator 2015 si dhe në formularin ESIG 027, ku në bazë të nenit 119 pika 3 gërma (a), të ligjit nr.9920 "*Për Procedurat Tatimore në*

Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar) subjekti është penalizuar me gjobë në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

Në vijim të procedurës nga pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Fier është nxjerrë njoftim vlerësimi për detyrime tatimor me nr.21514 datë 11.11.2015 në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë në ngarkim të subjektit Denion Çelaj.

Pala paditëse subjekti Denion Çelaj pasi ka marrë dijëni për njoftim vlerësimin tatimor me nr.21514 datë 11.11.2015 të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier ka ushtruar ankim administrative në datë 08.12.2015 pranë Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë, e cila me vendimin nr.40779/1 prot datë 28.01.2016 ka vendosur të “lënien në fuqi të aktit administrative njoftim vlerësimi për detyrime tatimor me nr.21514 datë 11.11.2015 të nxjerrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, për mos deklarimin e punonjësve pranë organeve tatimore në shumën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë dhe rrezimin e ankimit”.

Paditësi subjekti Denion Çelaj duke mos qenë dakort me njoftim vlerësimi nr.21514 datë 11.11.2015 të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, i lënë në fuqi nga Drejtoria e Apelit Tatimor Tiranë, i është drejtuar me kërkesë padi gjykatës duke pretenduar se;

Së pari; me akt konstatimin datë 15.09.2015, të mbajtur nga perfaqësuesit e pales së paditur Drejtoria Rajonale e Tatimore Fier, me akt konstatimi me nr. 0529788 serial datë 15.09.2015, është ushtruar kontroll në subjektin "Denion Çelaj", me aktivitet Tregti të Artilkujve Ushqimore. Pala e paditur ka konstatuar se në subjekt ka qenë shtetasja Trendelina Çelaj dhe ku është mbajtur proces-verbal Gjore nr.serial 0179057 dt.15.09.2015, ku grupi kontrollit ka sanksionuar paditësin me gjobe 50'000 leke.

Paditësi subjektit Denion Çelaj është njoftuar me "Njoftim Vlersimi per Detyrimet Tatimore ", shkresa nr.21514 prot datë 11.11.2015 me të cilën është vendosur gjoba, për punëmarren e padeklaruar, e lëshuar nga Drejtoria e Kontrollit pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, i derguar Subjektit "Denion Çelaj" person fizik.

Së dyti; pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, në mënyrë arbitrare dhe në kundërshtim me kushtet dhe kriteret ligjore ka vendosur gjobë për subjektin "Denion Çelaj".

Nga rrethanat e faktit të parashtruar konstatohet qartë se subjekti, nuk ka shkelur ligjin pasi shtetasja Trendelina Çelaj është nena e subjektit dhe nuk është punëmarre e padeklaruar, ku vendimi i marrë është në shkelje të ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republikë e Shqipërisë" të ndryshuar dhe akteve të tjera nenligjore si Udhëzime të Ministrit të Financave.

Në të njëjtat kushte e rrethana konstatohet se edhe kërkesa për Apelim, është plotësisht e ligjshme dhe e bazuar në prova e në ligj.

Për sa më sipër paditësi subjektit Denion Çelaj kërkoi nga gjykata pranimin e kërkesës padisë si të bazuar në ligj dhe në prova.

Pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, nëpërmjet përfaqësueses së saj ka kërkuar rrezimin e kerkese-padise duke prapësuar në gjykim se;

Së pari; nga administrimi i provave të ndodhura pranë DRT Fier, rezultoi se Kerkuesi subjekti Denion Çelaj person fizik me NIPT L43413401P,

me adrese Lagja "15 Tetori", rruga "Jakov Mile", Fier, me objekt kryesor të ushtrimit të aktivitetit "tregtia me pakice e frutave dhe perimeve", në datën 15.09.2015 i është mbajtur nga inspektorët e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, Akt Konstatimi me nr.serial 0529788 datë 15.09.2015, nëpërmjet së cilit është konstatuar se në punë u gjend Zj. Trendelina Çela, e cila nuk figuron e siguruar në skemën e sigurimeve, pra as në listepagesën e muajit Shtator 2015 dhe as në Formularin ESIG 027.

Mbi bazën e Akt Konstatimit të mesipër, inspektorët e DRT Fier, kanë mbajtur Proçesverbalin e gjobes me nr. Serial 179057 dt.15.09.2015, ku të dy aktet administrative të sipërcituara, pra si akt konstatimi me nr.serial 0529788 datë 15.09.2015, ashtu edhe Proçesverbali i Gjobes me nr. Serial 179057, datë 15.09.2015 janë pranuar dhe firmosur me dëshirë nga ana e Zj.Trendelina Çela, e vertetuar kjo me firmën në fund të akteve administrative të mesipërme.

Bazuar në dy aktet administrative të mesipërme, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier ka nxjerrë Njoftim Vleresimin për Detyrimet Tatimore me nr. 21514 dt. 11.11.2015, ku subj ektit "Denion Çelaj" i komunikohet gjoba në vlerën 50.000 për punonjës të pasiguruar në skemën e sigurimeve shoqërore, sipas Proçesverbalit të Gjobes me nr. Serial 0179057 dt.15.09.2015.

Me Njoftim Vleresimin me nr.21514 datë 11.11.2015, subjekti Denion Çelaj nuk ka qenë dakort dhe me shkresën protokolluar me tonen me nr.1692/1 datë 13.01.2016 e ka ankimuar pranë Drejtorisë së Apelit Tatimore në Drejtorinë e Përgjithshme, e cila në përfundim të shqyrtimit të ankimit administrativ ka vendosur "*Lenien në fuqi të Njoftim Vleresimit me nr. 21514 dt.11.11.2015, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier dhe rrezimit e ankimit*". Ky vendim i është komunikuar subjektit me shkresën nr.40779/1 dt.28.01.2016.

Së dyti; nga verifikimi i provave materiale të ndodhura pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, rezulton se akti Administrativ Njoftim Vleresim nr.21514 datë 11.11.2015 është konform legjislacionit tatimor në fuqi dhe nuk ka shkelje ligjore për konstatimin e tij si të pavlefshëm, apo për anulimin e tij.

Subjekti në kërkesë padi ka kërkuar konstatimin e pavlefshmerisë absolute dhe relative të akteve por në asnjë moment në kërkesë-padi nuk argumenton apo provon shkresërisht se përse Akti Administrativ Njoftim Vleresimi me nr. 21514 dt.11.11.2015 duhet të anulohet apo të konstatohet si absolutisht i pavlefshëm.

Kështu me Kodin e Procedurave Administrative në nenin 118, përcaktohen rastet se kur Aktet Administrative janë relativisht të pavlefshëm:

Neni 118 Aktet administrative relativisht të pavlefshme

"1. Aktet administrative do të quhen relativisht të pavlefshme, në kuptimin e këtij Kodi, kur ato janë nxjerrë në kundërshtim me ligjin, por megjithatë nuk janë absolutisht të pavlefshme".

Subjekti nuk argumenton se përse Akti Administrativ është në kundërshtim me ligjin, pasi gjëritja e tatimpaguesit për punonjës të padeklaruar, qofshin këta edhe punonjës pa pagesë brenda familjes, nëse nuk deklarohen në organet tatimore është parashikuar në nenin 119 të Ligjit "Për Procedurat Tatimore në R.Sh", i ndryshuar.

Ndersa ne Kodin e Procedurave Administrative neni 116, percaktohen rastet se kur Aktet Administrative konstatohen si absolutisht te pavlefshem:

Neni 116 "Akte absolutisht te pavlefshem"

2. Akti eshte nxjerre nga nje organ i pidentifikuar
2. Akti eshte nxjerre nga nje organ ne kapercim te kompetencave ligjore
2. Akti eshte nxjerre ne kundershtrim me formen dhe proceduren e kerkuar nga ligji

Ne rastin konkret Akt Konstatimi me nr. 0529788 dt.15.09.2015, ProeesVerbali me nr. 0179057, dhe Njoftim vleresimi me nr. 21514 dt.1.11.215 per subjektin "Denion Celaj" eshte kryer nga nje organ teresisht i indentifikueshem, qe eshte Drejtoria Rajoanle Tatimore Fier.

Drejtoria Rajoanle Tatimore Fier eshte teresisht kompetente per te kontrolluar subjektin "Denion Celaj", duke qene se ky subjekt administrohet nga DRT Fier, vertetuar ky fakt me ekstraktin e subjektit te printuar nga sistemi informatik i tatimeve c@ts.

Aktet administrativ Akt Konstatimi me nr. 0529788 dt.15.09.2015, ProeesVerbali me nr. 0179057, dhe Njoftim vleresimi me nr. 21514 dt.1.11.215 jane konform formes dhe procedures se kerkuar nga legjislacioni ne fuqi.

Së treti; keshtu Akt Konstatimi me nr.0529788 datë 5.09.2015, Proçes Verbali me nr.0179057, kane dale ne zbatim te Urdhrit te Punes me nr.12850 dt.15.09.2015, i cili ka dale ne zbatim te Ligjit nr.9920 "Per Procedurat Tatimore ne republiken e Shqiperise" i ndryshuar, dhe te Udhezimit nr.24 dt.02.09.2008 te dale ne zbatim te tij.

Akt Konstatimi dhe procesverbali jane konform neneve nr.106/107/108 e ne vijimte Kodit te Procedurave Administrative per Vlefshmerine e akteve, ne to eshte specifikuar cdo gje e konstatuar si dhe baza ligjore nepermjet se ciles subjekti eshte gjobitur. Akt Konstatimi dhe Proçesverbali i Gjebes jane Firmosur nga ana e Zj.Trendelina Çela.

Kontrolli i ushtruar ne subjektin "Denion Celaj" eshte ne perputhje me nenin 80 te Ligjit nr.9920/2008 dhe te UMF nr.24 dt.02.09.2008 "Per Procedurat Tatimore", ne te cilin percaktohet: 80. Kontrolli tatimor "80.1.1 Objektivi i kontrollit tatimor eshte sigurimi i plotesimit te detyrimeve tatimore nga ana e tatimpaguesve ne perputhje me legjislacionin tatimor ne fuqi, nepermjet zbulimit dhe parandalimit te shmangieve tatimore dhe evazionitfiskal. 80.3 Kontrollet tatimore jane:c) Verifikimet ne vend. Keto verifikime te shkurtra synojne zbulimin ne kohe te shkeljeve qe kane lidhje me regjistrimin e personave te tatueshem (identifikimin e personave te paregjistruar), me perdorimin e pajisjeve fiskale, me perdorimin e pullave fiskale ne mallrat e akcizes, me dokumentimin e mallrave ne ruajtje, perdorim dhe transport, me dokumentimin e shitjeve dhe leshimin faturave tatimore, etj. Keto verifikime kryhen pa njoftimin paraprak te personave te tatueshem, por vetem nepermjetprezantimit ne momentin e verifikimit, te dokumentitpersonal te verifikuesit dhe urdhrin e dites, te leshuar nga drejtuesi i drejtorise se kontrollit per verifikime ne vend".

Pretendimi i subjektit se Zj.Trendelina Çela eshte nena e subjektit dhe jo punonjes i padeklaruar dhe per kete arsye nuk duhet te gjobitet nuk qendron, pasi referuar nenit nr.119 te Ligjit nr.9920 "Per Procedurat Tatimore ne republiken e Shqiperise" i ndryshuar, subjekti ka detyrim ligjor per te deklaruar edhe pjestaret e familjes te cield punojnë ne vendin e ushtrimit te biznesit.

Së katërti; gjithashtu akt konstatimi dhe procesverbali i gjobes i mbajtur ne subjektin "Denion Celaj", jane ne perputhje me ligjin "Per Kundrvajtjet administrative", keshtu ne nenin nr.6 pika a percaktohet se shkeljet percaktohen me ligj. Keshtu mosdeklarimi i punonjesve , qofshin keta dhe punonjes papagese te familjes perben shkelje konform nenit 119 te ligjit "Per Procedurat Tatimore"

Ndersa ne nenin nr.7 te Ligjit Per Kundrvajtjet Administrative percaktohet: *Neni 7 Kompetenca per konstatimin dhe shqyrtimin e kundervajtjes "1. Kompetenca per konstatimin e kundervajtjes, me perjashtim te rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, pergjegjes per zbatimin e ligjit te posaçem " .*

Keshtu ne nenin nr.2 te ligjit "Per Procedurat Tatimore", percaktohet se Administrata Tatimore eshte pergjegjese per zbatimin e ketij ligji.

Gjithashu gjoba e vendosur eshte ne perputhje me nenin nr. 13 te Ligjit Per Kundrvajtjet Administrative, ku percaktohet se "Menyrat e marrjes se vendimit per kundervajtjen administrative"; *L.Per kundervajtjen administrative parashikohet: marrja e gjobes ne vend, ne rastet kur kjo parashikohet nga ligji i vegante; mbajtja e aktit administrativ qe konstaton shkeljen apo e nje dokumenti tjeter te barasvlershem me te nga personat e ngarkuar me ligj ose me akte te organeve te pushtetit vendor, ne rastet kur konstatimi i shkeljes eshte i lidhur me vendin ku ndodh ngjarja;"*.

Gjithashtu Njoftim Vleresimi nr. 21514 datë 11.11.2015 eshte konform legjislacionit tatimor ne fuqi. Keshtu Njoftim Vleresimi i mesiper ka dale ne perputhje me Procesverbalin e Gjobes me nr.0179057 dt.15.09.2015. Ky njoftim Vlersimi eshte ne perputhje me Nent nr.68 e ne vijim te Ligjit nr.9920/2008 "Per Procedurat Tatimore ne R.Sh".

Drejtoria Rajonale Tatimore nuk eshte ne kundersizim me ligjin ne nxjerrjen e Njoftim Vleresimit Nr. 21514 dt 11.11.2015, pasi ne nenin nr.70 te ligjit "Per Procedurat Tatimore" percaktohet e drejta e Administrates Tatimore Per nxjerrjen e Njoftim Vlersimit.

Gjithashtu Vendimi i Drejtorise se Apelimit Tatimor me nr.40779 dt.28.01.2016 eshte teresisht konform ligjit. Keshtu ankimim i subjektit "Denion Celaj" eshte marre ne shqyrtim conform nenit 106 pika 1, 2 dhe3, dhe nenit 107 pika 2 te Ligjit nr.9920 "Per Procedurat Tatimore".

Ne keto kushte ne zbatim te neneve nr.106/107/108/109 te Ligjit nr.9920 dt.19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" dhe te Udhezimit te Ministrit te Financave nr.24 datë 02.09.2008 te dale ne zbatim te tij, Drejtoria e Apelimit Tatimor merr vendim per Lenien ne Fuqi te Aktit Administrativ, Njoftim Vleresimi nr.21514 datë 11.11.2015.

Per sa me siper edhe vendimi i Drjtorise se Apelimit Tatimor eshte teresisht i vlefshem dhe ligjor dhe nuk ka baze ligjore per konstatimin e tij si absolutisht te pavlefshem.

Për sa me sipër pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, nëpërmjet përfaqësueses së saj ka kërkuar nga gjykata rrëzimin e kërkesë padisë si e pabazuar në ligj dhe në prova.

Pala e paditur Drejtoria e Apelimit Tatimor Tiranë nuk u dëgjua në këtë gjykim dhe nuk ka depozituar prapësime apo konkluzione përfundimtare me shkrim pranë sekretarisë gjyqësore të kësaj gjykate pasi është vijuar

gjkimi në mungesë me gjithë njoftimin e rregullt që kishte për procesin gjyqësor.

Pala e pjesëmarrëse në gjykim Avokatura Shtetit Zyra Vendore Vlore nuk u dëgjua në këtë gjykim dhe nuk ka depozituar prapësime apo konkluzione përfundimtare me shkrim pranë sekretarisë gjyqësore të kësaj gjykate pasi është vijuar gjykimi në mungesë me gjithë njoftimin e rregullt që kishte për procesin gjyqësor.

Gjykata pasi kreu një hetim të plotë dhe të gjithanshëm, administroi provat e paraqitura në gjykim çmon se kërkesë padia e paraqitur nga paditësi shoqëria është e pabazuar në ligj e në prova dhe si e tillë do të bëhet rrëzohet.

Arsyetimi ligjor:

Në nenin 15 të ligjit nr.49/2012 "Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" parashikohet se "

Të drejtën e padisë e ka:

a) çdo subjekt, që pretendon se i është cënuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik.

Në nenin 17 të ligjit nr.49/2012 "Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" parashikohet se "Padia ngrihet":

a) për shfuqizimin teresisht apo pjeserisht të aktit administrative;

c) për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ;

Rezulton se pala paditëse subjekti person fizik Denion Celaj, nuk ka një interes legjitim për të kërkuar pavlefshmërinë relative dhe absolute të aktit administrativ të njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nxjerrë nga pala e paditur, pasi akti administrativ është nxjerrë nxjerrë në zbatim të ligjit material.

Çështja objekt gjykimi rregullohet nga ligji nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar) si dhe aktet nën ligjore të dala në zbatim të tij.

Rezulton që Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier ka ushtruar kontroll pranë subjektit Denion Çelaj dhe ku në përfundim të kontrollit është akt konstatimi me nr.0529788 serial datë 15.09.2015 ku ka rezultuar se shtetasja e gjetur në ambjentet e subjektit Trendelina Çela nuk figuron e siguruar në skemen e sigurimeve në listepagesen e muajit Shtator 2015 dhe ku në vijim nga pala e paditur është mbajtur proces verbali i gjobes me nr.0179057 serie datë 15.09.2015 ku është saksionuar me gjobë paditësi në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë për shkelje të nenit 119 pika 3 gërma (a), të ligjit nr.9920 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar).

Në nenin 119 të ligjit nr.9920 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar) parashikohet se "1.Nëse nga verifikimi dhe kontrolli në vendndodhjen e biznesit rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar në organin tatimor çdo të punësuar rishtazi, të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës, përveç detyrimit për pagimin e shumës së detyrimeve tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të llogaritura nga data e konstatimit, dënohet me gjobë për çdo punonjës të padeklaruar si më poshtë: a)

tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin, me gjobë prej 500 000 (pesëqind mijë) lekësh;**b) tatimpaguesit e tjerë, me gjobë prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh.**

Çdo konstatim i përsëritur i mosdeklarimit të punonjësve, pas aplikimit të dënimit administrativ, si në pikën 1, të këtij neni, konsiderohet evazion tatimor, sipas nenit 116 të ligjit, dhe administrata tatimore ushtron të drejtën e parashikuar në nenin 131, të këtij ligji, duke e bërë kallëzimin penal për tatimpaguesin.

Rezulton se punonjësja duhet të ishin deklaruar një ditë më parë se të fillonin punë.

Sa më sipër, gjykata çmon se "Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore me nr.21514 prot datë 11.11.2015 si dhe vendimi nr.40779/1 prot datë 28.01.2015 i Drejtorisë së Apelit Tatimor" janë vendime të nxjerra në zbatim me të ligjit nr.9920 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar) si dhe akteve nënligjore të nxjerrë në zbatim të tij.

Rezulton se pala paditëse subjekti fizik Denion Çela në objektin e kërkesë-padisë kërkon konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore me nr.21514, date 11.11.2015 te Drejtorise Rajonale te Tatimeve Fier lene ne fuqi me vendimin nr. 40779, date 28.01.2016 te Drejtorise se Apelit Tatimor Tirane

Gjykata çmon se njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore me nr.21514 prot date 11.11.2015 perben nje akt administrativ individual ne kuptim te nenit 105 te K.Pr.Administrative sipas te cilit **"Per qellimet e ketij ligji, do te konsiderohen akte administrative te gjitha vendimet e organeve te administrates publike, te cilat krijojne pasoja juridike ne raste individuale"**.

Si nje akt administrativ individual, ky akt do ti nenshtrohet percaktimeve ligjore qe parashikon Kodi i Procedurave Administrative per aktet administrative ne pergjithesi dhe per aktet me karakter individual ne veçanti.

Rezulton se pala paditese kerkon pavlefshmërinë absolute të aktit administrative, njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr.21514 prot datë 11.11.2015 si një akt administrative absolutisht i pavlefshëm si një nga format e pavlefshmërisë së akteve administrative parashikuar në nenin 115 të Kodit të Procedurave Administrative sipas të cilit **"Pavlefshmëria e akteve administrative, në kuptimin e ketij Kodi, paraqitet ne format e meposhtme:**

a) akte administrative absolutisht të pavlefshme (akte të nxjerra në kundërshtim flagrant me ligjin);

b) akte administrative relativisht të pavlefshme (akte të nxjerra në kundërshtim me ligjin).

Në nenin 116 të K.Pr.Administrative parashikohet tre rastet se kur nje akt administrativ eshte absolutisht i pavlefshem dhe konkretisht **'Aktet administrative do te quhen absolutisht te pavlefshme, ne kuptimin e ketij Kodi, ne rastet e meposhtme:**

a) kur akti eshte nxjerre nga nje organ administrativ i pidentifikuar;

b) kur akti është nxjerre nga një organ administrativ në kapercim të kompetencave të tij ligjore;

c) kur akti është nxjerre në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji.

Rezulton se akti administrativ, njoftim vleresimi për detyrimet tatimore nr.21514 datë 11.11.2015 nuk është një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm pasi është nxjerrë nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier, i cili është organi i cakuar me ligj për zbatimin e ligjit "Për procedurat tatimore", është nxjerre nga një organ i identifikuar dhe është nxjerre në zbatim të formës dhe procedurës ligjore.

Pra gjykata çmon se nuk jemi para një akti administrativ absolutisht të pavlefshëm që në kuptim të 18 pika 8 të tij, kerkimi për konstatimin e pavlefshmerisë absolute të aktit administrative të ngrihet në çdo kohë.

Bazuar në nenin 45 të ligjit me nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative" kundër këtij vendimi të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë nuk parashikohet ankimi pasi masa e saknionit me gjohë për kryerjen e kundravajtjes administrative është në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë pra është më e vogël se njëzet-fishi i pagës minimale në shkallë vendi dhe ku për këtë arsye kundër këtij vendimi nuk lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Sa më sipër gjykata vendos rrëzimin e kërkesës padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova.

Në zbatim të nenit 106 të K.Pr.Civile, shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës paditëse.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, bazuar në nenin 40 dhe 41 të ligjit me nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", nenet 306-310 të Kodit të Procedurës Civile

V E N D O S I

- 1-Rrëzimin e kërkesës padisë.
- 2-Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës paditëse.
- 3-Kundër vendimit nuk parashikohet ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

U shpall në Vlorë, sot më datë 19.04.2016

SEKRETARE

Edlira SHEHU

SHPENZIMET GJYQËSORE

Taksa e regjistrimit
Njoftime
TOTALI

3.000 (tre mijë) lekë.
480 (katerqind e tetdhjete) lekë.
3.480 (tre mijë e katerqind e tetdhjete) lekë.

GJYQTARE

Gentiana XHELILI

